



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHË EKONOMISE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

DEGA E DOGANËS LEZHE

Nr. 248 Prot.

Lezhe më, 17/02 2026

VENDIM Nr. 2/

Sot, më datë 17.02.2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Lezhe, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në lidhje me konstatimin e mbajtur në ngarkim të subjektit "MAKE ALBA" sh.p.k me NIPT M12103503U,

KONSTATOVA SE:

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa nr.1404/9 Prot., datë 11.08.2025 me lëndë "Dërgohet raporti final për auditimin e kryer në Doganën Lezhe"

Ne zbatim të Raportit Final të Auditit të Brendshëm ndaj subjektit "MAKE ALBA" sh.p.k me NIPT M12103503U në Degen e Doganës Lezhe është mbajtur procesverbali perkates date 30.10.2025.

Rezulton se subjekti "MAKE ALBA" sh.p.k me NIPT M12103503U është pajisur me Autorizimin për perjashtim nga TVSH-ja date 21.12.2022 me afat vlefshmerie deri me 25.12.2022. Subjekti ka importuar makineri me kod Shtesë IP0, Kodi i procedurës të zgjeruar 4000, sipas autorizimit të përjashtimit nga TVSH të cituar më sipër sipas deklarates doganore R 2784 date 21.12.2022.

Rezulton se, subjekti nuk ka kryer veprimtari ekonomike nën regjimin e RPA pas datës 21.06.2023, si e till nuk u ka dhënë destinacion doganor mallrave të përjashtuar. Në nenin 9, të VKM-së nr. 953 dt. 29.12.2014, 'Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014' neni 8. Shkresës nr.27864/1 prot, datë 21.11.2014 të DPD, parashikohet që nëse brenda 3 (tre) vjetësh nga momenti i marrjes së autorizimit të përjashtimit nga TVSH-ja, operatori ekonomik nuk ka kryer aktivitet përpunimi aktiv (import-rieksport mallrash nën regjimin e përpunimit aktiv), automatikisht duhet të paguajë tatimin e vlerës së shtuar, për të cilin ka përfituar përjashtimin përkatës.

Fakti që, subjekti nuk kanë kryer asnjë investim, nuk kanë vënë makineritë në funksion ekonomik të autorizimeve, nuk kanë njoftuar autoritetet doganore mbikqyrëse për ndryshim të rrethanave ekonomike të tij, përbën shkelje doganore.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 28/1/2, 250/1a/4, 253/b.c, 258/1.a dhe 276 të Ligjit nr.102/2014. datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) ndaj këtij subjekti

V E N D O S A :

- Te paguaje detyrimin doganor ne shumen **35 058 (Tridhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e tete) leke**
- Te denoje me gjobe ne shumen **105 174 (Njëqind e pesë mijë e njëqind e shtatedhjetë e kater) leke.**
- Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor këtu, të kryejë menjëherë kontabilizimin e shumes se mesiperme.

Kundër këtij vendimi, subjekti " **MAKE ALBA**" sh.p.k me NIPT M12103503U , lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*".

Artan SULEJMANI

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS LEZHE

Nr. 262 Prot:

Lezhe më, 17 / 02 / 2026

VENDIM Nr. 35

Sot, më datë 17.02.2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Lezhe, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në lidhje me konstatimin e mbajtur në ngarkim të subjektit “MAKE ALBA” sh.p.k me NIPT M12103503U ,

KONSTATOVA SE:

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa nr.1404/9 Prot., datë 11.08.2025 me lëndë “Dërgohet raporti final për auditimin e kryer në Doganën Lezhe”

Ne zbatim të Raportit Final të Auditit të Brendshëm ndaj subjektit “MAKE ALBA” sh.p.k me NIPT M12103503U në Degen e Doganës Lezhe është mbajtur procesverbali perkates date 30.10.2025.

Rezulton se subjekti “MAKE ALBA” sh.p.k me NIPT M12103503U është pajisur me Autorizimin për Regjimin e Perpunimit Aktiv nr.7487/1 date 31.01.2022.

Rezulton se subjekti nuk ka paraqitur Dokumentin e mbylljes së Regjimit parashikuar në nenin 230 të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) dhe sipas Udhezimit nr.04 date 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Perpunimit Aktiv”.

Për këtë arsye është propozuar që subjekti të penalizohet në bazë të nenit 257/1b të Kodit Doganor.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 230,250/1a, 252.c, 257/1.b dhe 276 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) ndaj këtij subjekti

V E N D O S A :

- Te dënoje me gjobe ne shumen **50 000** (Pesedhjetë mijë) leke.
- Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor këtu, të kryejë menjëherë kontabilizimin e shumes se mesiperme.

Kundër këtij vendimi, subjekti " **MAKE ALBA**" sh.p.k me NIPT M12103503U , lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

DEGA E DOGANËS LEZHE

Nr. 267 Prot.

Lezhe më, 17/02 2026

VENDIM Nr. 40

Sot, më datë 17.02.2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Lezhe, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në lidhje me konstatimin e mbajtur në ngarkim të subjektit “AGOSTINI IT SHOES” sh.p.k me NIPT L97625301T,

KONSTATOVA SE:

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa nr.1404/9 Prot., datë 11.08.2025 me lëndë “Dërgohet raporti final për auditimin e kryer në Doganën Lezhe”

Ne zbatim të Raportit Final të Auditit të Brendshëm ndaj subjektit “AGOSTINI IT SHOES” sh.p.k me NIPT L97625301T në Degen e Doganës Lezhe është mbajtur procesverbali perkates date 30.10.2025.

Rezulton se subjekti “AGOSTINI IT SHOES” sh.p.k me NIPT L97625301T është pajisur me Autorizimin për Regjimin e Perpunitimit Aktiv nr.10529/1 date 22.04.2020.

Autorizimi për Regjimin e Perpunitimit Aktiv nr.10529/1 date 22.04.2020 rezulton me gjendje malli pa i dhene destinacion në sasinë 2 302 kg ndërkohe që vlera materiale rezulton pa diferencë.

Nga ana e subjektit nuk është paraqitur Dokumenti i mbylljes së Autorizimit sipas Aneks 8 të parashikuar në Udhezimin nr.04 date 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Perpunitimit Aktiv”

Për arsye të mosrespektimit të afatit të dorëzimit të dokumentit të mbylljes së Autorizimit është propozuar që subjekti të penalizohet në bazë të nenit 257/1b të Kodit Doganor

Për sa më lart, mbështetur në nenin 230,250/1a, 252.c, 257/1.b dhe 276 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) ndaj këtij subjekti

V E N D O S A :

- Te denoje me gjobe ne shumen **50 000** (Pesedhjetë mijë) leke.
- Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor këtu, të kryejë menjëherë kontabilizimin e shumes se mesiperme.

Kundër këtij vendimi, subjekti " **AGOSTINI IT SHOES**" sh.p.k me NIPT **L97625301T** , lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi. pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS LEZHE

Nr. 289 Prot.

Lezhe më, 23/02 2026

VENDIM Nr. 43

Sot, më datë 23.02.2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Lezhe, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në lidhje me konstatimin e mbajtur në ngarkim të subjektit **"COMFORT ALDOMA" – Shpk me NIPT L68431301T,**

KONSTATOVA SE:

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa nr.1404/9 Prot., datë 11.08.2025 me lëndë "Dërgohet raporti final për auditimin e kryer në Doganën Lezhe" Ne zbatim të Raportit Final të Auditit të Brendshëm ndaj subjektit **"COMFORT ALDOMA" – Shpk me NIPT L68431301T** ne Degen e Doganes Lezhe eshte mbajtur procesverbali perkates date 30.10.2025.

Rezulton se subjekti **"COMFORT ALDOMA" – Shpk me NIPT L68431301T** eshte pajisur me Autorizimin per perjashtim nga TVSH-ja me nr.02, (223/1 prot.), datë 05.02.2018 me afat vlefshmërie deri 10.02.2018. . Subjekti ka importuar makineri me kod Shtesë IP0, Kodi i procedurës të zgjeruar 4000, sipas autorizimit të përjashtimit nga TVSH të cituar më sipër sipas deklarates doganore R 300 date 06.02.2018.

Rezulton se, subjekti nuk ka kryer veprimtari ekonomike nën regjimin e RPA, si e till nuk u ka dhënë destinacion doganor mallrave të përjashtuar. Në nenin 9, të VKM-së nr. 953 dt., 29.12.2014, 'Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014' neni 8. Shkresës nr.27864/1 prot, datë 21.11.2014 të DPD. parashikohet që nëse brenda 3 (tre) vjetësh nga momenti i marrjes së autorizimit të përjashtimit nga TVSH-ja, operatori ekonomik nuk ka kryer aktivitet përpunimi aktiv (import-rieksport mallrash nën regjimin e përpunimit aktiv), automatikisht duhet të paguajë tatimin e vlerës së shtuar, për të cilin ka përfituar përjashtimin përkatës.

Fakti që, subjekti nuk kanë kryer asnje investim, nuk kanë vënë makineritë në funksion ekonomik të autorizimeve, nuk kanë njoftuar autoritetet doganore mbikqyrëse për ndryshim të rrethanave ekonomike të tij, përbën shkelje doganore.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 28/1/2,250/1a/4, 253/b.c, 258/1.a dhe 276 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) ndaj këtij subjekti

VENDOSA:

- Te paguaje detyrimin doganor ne shumen **200 159 (Dyqind mije e njeqind e pesedhjetë e nente)** leke
- Te denoje me gjobe ne shumen **600 477 (Gjashteqind mije e katerqind e shtatedhjetë e shtatë)** leke.
- Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor këtu, të kryejë menjëherë kontabilizimin e shumes se mesiperme.

Kundër këtij vendimi, subjekti **"COMFORT ALDOMA"** – Shpk me NIPT **L68431301T** , lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi. pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*".

